



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA E APELIT PRISHTINË**

---

Numri i lëndës: 2021:223248  
Datë: 04.06.2024  
Numri i dokumentit: 05776336

AC.nr.3840/22

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Halide Reka dhe Naime Ahmeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Komuna e Junikut, kundër të paditurit Sh.G, për lirimin e paluajtshmërisë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Deçan, C.nr.81/15, të datës 07.03.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 04.06.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

APROVOHET si e themeltë ankesa e paditëses Komuna e Junikut dhe ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Pejë- Dega në Deçan, C.nr.81/15, të datës 07.03.2022 dhe lënda kthehet në gjykatën e shkallës së parë në procedim të serishëm.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Pejë- Dega në Deçan, me aktvendimin ankimor C.nr.81/15, të datës 07.03.2022, ka vendosur më sa vijon: Padia e paditëses Komuna e Junikut, kundër të paditurit Sh.G, objekt kontesti Kthim, lirim i palujtshmerisë, **KONSIDEROHET E TËRHEQUR.**

Kundër këtij aktvendimi, paditësja në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim që Gjykata e Apelit ta pranojë si të bazuar ankesën e paditëses dhe lëndën t’ia kthejë gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

I padituri nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 208 dhe nenin 209 të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa e paditëses është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja Komuna e Junikut, me dt.12.01.2015, në gjykatën e shkallës së parë ka ushtruar padi për kthimin dhe lirimin e paluajtshmërisë, me propozim për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë, kundër të paditurit Sh.G, me arsyet sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin C.nr.81/2015, të datës 04.02.2022, e ka refuzuar propozimin e paditëses-propozueses për caktimin e masës së përkohshme të sigurisë (*duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi*).

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin C.nr.81/2015, të datës 04.02.2022, e ka ftuar paditësen Komuna e Junikut ta bëjë precizimin e padisë në afat prej 3 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktvendimi, në të kundërtën do të konsiderohet e tërhequr padia, e në qoftëse kthehet pa u plotësuar e njëjta do të hedhet poshtë.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, C.nr.81/15, të datës 07.03.2022, e ka konsideruar të tërhequr padinë e paditëses konform nenit 102.3 të LPK-së, me arsyetim se e njëjta nuk ka vepruar konform aktvendimit për precizim të padisë (*duke vendosur me decidivisht si në dispozitiv të këtij aktvendimi*).

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe i ligjshëm pasi që aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1, lidhur me nenin 99 dhe 102 të LPK-së.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, pas analizimit dhe shqyrtimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, në raport me pretendimet ankimore erdh në përfundim se ankesa e paditëses është e bazuar, për arsye se sipas nenit 99 par.2 të LPK-së parashihet që: *“Parashitësit duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë çdo gjë që nevojitet dhe e mundëson veprimin sipas tyre. Ato duhet të përmbajnë sidomos: emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin (emërtimin e personit juridik), vendbanimin apo vendqëndrimin (selinë e personit juridik) e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor apo me prokurë, po që se i kanë, objektin e kontestit, përmbajtjen e deklaratës dhe firmën e parashitësit”*. Ndërsa sipas nenit 102 par.1 të LPK-së parashihet që: *“Kur një parashitës nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do ta thërrasë personin që e dërgon ta korrigjojë ose ta plotësojë parashitësen. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhë treditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashitëses”*, andaj në rastin konkret është shumë e paqartë se çka ka kërkuar gjykata në aktvendimin për precizim të padisë, pasi që e njëjta në dispozitiv të saj vetëm ka cekur se citoj: *“Saktë të bëhet prezicimi i kërkesëpadisë sepse për gjykatën është e pakuptueshme dhe të siguroj prova të mjaftueshme për gjykatën dhe për palët në procedurë”*, çka do të thotë se gjykata e shkallës së parë nuk e ka udhëzuar saktë palën për plotësimet dhe korrigjimet dhe duke ju referuar shkresave të lëndës, konkretisht petitumit të padisë, konstatohet se paditësi ka kërkuar kthimin dhe lirimin e paluajtshmërisë nga personat dhe pengesat fizike të montuara, në parcelën me nr. X, pronë shoqërore ZK Junik, ku si dëshmi ja ka bashkangjitur certifikatën e pronësisë, të dt.15.12.2014, në bazë të të cilës evidentohet se parcela në fjalë është pronë shoqërore, konstatimin e gjendjes faktike, ekspertizën gjeodezike etj., andaj në rastin konkret, nxjerrja e vendimit për precizim të kërkesëpadisë nga gjykata e shkallës së parë ka qenë e pa nevojshme, pasi që kërkesa e paditësit në padi ka qenë e qartë dhe e specifikuar dhe gjykata e shkallës së parë ishte dashur të veproj konform nenit 2.1 të LPK-së.

Prandaj, shkeljet e tilla të cekura më lartë përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë, andaj aktvendimi i atakuar doemos është dashur të anulohet.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e dispozitave të sipërcituara, të cilat në ri procedurë duhet të eliminohen në atë mënyrë që me rastin e shqyrtimit të çështjes, udhëzohet të caktojë shqyrtimin përgatitorë/kryesor dhe të ftohen palët ndërgjyqëse në mënyrë të rregullt si dhe të vlerësohen të gjitha faktet me rëndësi vendimtare sipas kërkesave dhe kundërshtimeve të palëve, me qellim që të nxjerrë një vendim të ligjshëm dhe të drejtë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, nenit 209, par.1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
Ac.nr.3840/22, me datë 04.06.2024

Kryetar i kolegjit-Gjyqtari  
Liridon Maloku

Numri i lëndës: 2021:223248  
Datë: 04.06.2024  
Numri i dokumentit: 05776336